

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË SH.A UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Ujësjellës Kanalizime” sh.a Tiranë. me objekt “Për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” për periudhën 01.07.2009 deri më datë 31.12.2011, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 101 datë 30.06.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 176/7 datë 30.06.2012, dërguar [REDACTED] Drejtor i Përgjithshëm në Ujësjellës Kanalizime” Sh.a Tiranë, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

- Për Këshillin Mbikëqyrës

1. Të konstituohet asambleja e aksionarve për të bërë të mundur funksionimin e organeve drejtuese të shoqërisë, në përputhje me statutin dhe dispozitat ligjore në fuqi.

menjëherë

2. Asambleja e aksionarëve të bëjë ndryshimet në përbërjen e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, të cilët deri tani janë emëruar nga METE, në kundërshtim me VKM nr.677, datë 3.10.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.642, datë 11.10.2005 të Këshillit të Ministrave për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive anonime shtetërore”, ku emërimi i tyre bëhet nga asambleja e zakonshme aksionarve.

menjëherë

3. Të revokohet Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 06, datë 22.01.2010 “Për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe dietave për punonjësit e UKT sha, kur dalin jashtë shtetit, pasi bie në kundërshtim me VKM nr.304, datë 08.05.2003, i ndryshuar me VKM nr.870, datë 14.12.2011.

menjëherë

4. Këshilli Mbikëqyrës të marrë në analizë Departamentin e Shitjes për problemet e faturimit, arkëtimit, lidhjen e kontratave të reja, duke synuar në përmirësimin e këtyre treguesve si dhe realizimin e objektivave të programuara.

Vazhdimisht

5. Këshilli Mbikëqyrës duhet të lidh kontratën me drejtorin e Përgjithshëm për detyrimet që rrjedhin në administrimin e shoqërisë në zbatim të nenit 21 pika 3, të statutit të shoqërisë U.K.T sh.a, pasi mungon kontrata.

Në fillim të çdo viti

-Për Drejtorin e Përgjithshëm

6. Për të gjitha investimet e programuara në përmirësimin e rrjetit ekzistues, projektet duhet të shoqërohen me analizën e impaktit pozitiv që do të sjellë kryerja e investimeve për çdo objekt në drejtëm të uljes së humbjeve në rrjet, duke e ndjekur në vazhdimësi realizimin e këtyre objektivave.

vazhdimisht

7. Autoriteti Kontraktor të likuadojë situacionet e kontraktuesve për punimet e kryera ,në përputhje me afatet e kontratës, pasi moszbatimi i kontratës krijon risk për pagesa të tepërta nga U.K.T. sh.a.

vazhdimisht

8. U.K.T sh.a të marrë masa për pajisjen me matës të të gjithë abonentëve që furnizohen me ujë nga rrjeti i Ujësjellës Kanalizime sh.a Tiranë, duke minimizuar numrin e abonentëve me faturim afrofe.

brenda vitit 2012

9. Të bëhen ndryshime në rregulloren e brendshme të shoqërisë ku të implementohen sistemet e kontrollit të brendshëm dhe treguesit e performancës, të cilët për çdo tre muaj dërgohen në Drejtorinë e Përgjithshme Ujësjellës Kanalizime (D.P.U.K.)

menjëherë

10. Të merren masa për rekrutimin e punonjësve me integritet të lartë etik dhe moral për të bërë të mundur kryerjen e detyrës në përputhje me kodin etik dhe rregulloren e brendshme, me synim përmirësimin e treguesve të performancës dhe shërbimit ndaj abonentëve, familjarë , privatë etj.

vazhdimisht

11. Të bëhet vlerësimi i stafit drejtues për çdo Departament, Degë , Sektorë dhe Njësi në përputhje me realizimin e objektivave të programuar për çdo vit, duke bërë ndryshimin e stafeve drejtuese për çdo pozicion pune që paraqitet me mosrealizime të treguesve të programuar.

vazhdimisht

12. Njësia e Prokurimit të bëj ndjekjen e realizimit të procedurave të prokurimit në përputhje me regjistrin e parashikimit të prokurimeve, procedurat dhe fondet e parashikuara, pasi gjatë vitit konstatohen ndryshime të mëdha në objektet e prokuruar.

vazhdimisht

13. Të merren masa për përmirësimin e treguesve të performancës për raportet: prodhim-faturim, faturim – arkëtim për të realizuar përmirësimin e situatës financiare të shoqërisë dhe uljen e humbjeve në rrjet.

vazhdimisht

14. Njësia e prokurimit në hartimin e dokumenteve të tenderit të përdorë formulime të sakta në kriteret e veçanta të kualifikimit në përputhje me DST, pasi në mjaft raste ka krijuar konfuzion në vlerësimet e bëra nga KVO.

vazhdimisht

15. Programimi i investimeve duhet të jetë i mbështetur me burime financiare, pasi mungesa e tyre sjell impakte negative në likuidimin e kontraktorëve që janë me pasoja, ku për vonesat në likuidim janë parashikuar penalitete.

vazhdimisht

16. Në prokurimin e fondeve të zhvillohen procedurat e prokurimit “Tender i hapur” dhe në rastet e përdorimit të procedurave të tjera kryesisht “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit” të bëhet një argumentim rigoroz për domosdoshmërinë e përdorimit të kësaj procedure.

vazhdimisht

17. Titullari i Autoritetit Kontraktor të tregoj kujdes të veçantë në shqyrtimin dhe vlerësimin e raporteve Përmbledhës të paraqitur nga KVO, veçanërisht për rastet kur janë skualifikuar

operatorë ekonomik që kanë paraqitur oferta me vlerë më të ulët se ajo që është shpallur fituese, pasi konstatohen raste që në vlerësimet e bëra nga KVO përdoren dy standarde.

vazhdimisht

18. Të merren masa për vendosjen e “taometrit” në makineritë e rënda si dhe të “aparitit të matjes së kilometrave” në të gjithë automjetet lëvizëse, për të bërë të mundur auditimin e zbatimit të normativave në drejtim të harxhimit të karburanteve. rekomandim i lënë edhe në auditimin e kaluar.

brenda vitit 2012

19. Për shkeljet e konstatuara në përmbushjen e detyrës nga çdo punonjës të shoqëruara me manipulime dhe abuzime në faturimin e abonentëve familjarë dhe kryesisht ata privat, të merren masa disiplinore deri në largim nga puna, jo vetëm për punonjësit që abuzojnë me detyrën por edhe ndaj stafit drejtues që ka për detyrë të monitorojë punën e sektorit që mbulon, deri tek drejtuesi kryesor që përgjigjet për drejtimin e Departamentit

vazhdimisht

20. Të bëhet identifikimi i të gjithë abonentëve familjarë, privatë, institucioneve buxhetore, jo buxhetore etj, duke përcaktuar vendndodhjen e tyre sipas zonave ku gjenden, me synim të pajisjes së tyre me kontrata furnizimi me ujë, të cilat të hidhen në hartën përkatëse.

vazhdimisht

21. Drejtori i Përgjithshëm dhe Këshilli Mbikëqyrës, të shqyrtojnë detyrimet e U.K.T sh.a ndaj kreditorëve, pasi gjendja e llogarisë “furnitorë”, për vitin 2010 është në vlerën 272,341 mijë lekë dhe në vitin 2011, këto detyrime arrijnë në 452,234 mijë lekë, rritje që ka ardhur si rezultat i kryerjes së investimeve pa patur aftësi paguese. Vetëm detyrimi ndaj firmave ndërtuese është rreth 310 milionë lekë.

vazhdimisht

22. U.K.T. sha të marrë masa për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime sh.a Tiranë në regjistrin e pasurive të paluajtshme në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë , sipas kërkesave të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, ndryshuar me ligjin nr. 9407, datë 19.5.2005.

menjëherë

23. Njësia e Auditit të Brendshëm, të programojë misione, angazhime në funksion të analizës dhe vlerësimit të riskut.

vazhdimisht

24. Drejtori i Përgjithshëm, në zbatim të nenit 8, pika 8, germa b të Ligjit nr.10.296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin dhe Kontrollin Financiar”, të ngrëjë grupin e menaxhimit strategjik të njësisë publike, në përputhje me kërkesat e nenit 27 të këtij ligji;

menjëherë

25. Njësia e Auditit të Brendshëm të programojë misione për të vlerësuar shkallën e implementimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm për çdo vend pune, sektorë, degë , drejtori, Departament në rregulloren e brendshme të U.K.T. sha, udhëzimet, urdhrat e brendshëm

të nxjerra nga Drejtori i Përgjithshëm në përputhje me Ligjin nr.10.296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”

menjëherë

26. Njësia e Auditit të brendshëm gjatë misionëve të kryera për shkeljet, veprimet abuzive të konstatuara në punën e faturuesve, përgjegjësve të faturimit, hidraulikëve dhe arkëtareve të Njësive krahas masave disiplinore dhe çdëmtuese të rekomanduar për këta punonjës duhet të rekomandoj masa edhe për drejtuesit e lartë që përgjigjen për mbarëvajtjen e punës për këto Njësi.

vazhdimisht

27. Autoriteti Kontraktor për përcaktimin e kufirit limit të vlerës së kontratës përveç burimeve që përcakton legjislacioni i prokurimeve duhet të marrë më tepër se tre oferta nga operatorët ekonomik që figurojnë në listën e përditësuar të këtyre operatorëve që merren me importimin dhe shitjen e mallrave e materialeve që përdoren në sistemin e ujësjellës-kanalizimeve, të mbajtur nga Dega e Furnizimit.

vazhdimisht

28. Të bëhet azhurnimi për çdo Njësi sipas territorit që mbulojnë për të evidentuar numrin e abonentëve familjarë, privatë, Institucioneve etj duke siguruar të dhëna krahasuese nga Cez shpërndarje, Organet Tatimore dhe Organet e Pushtetit Vendor, pasi gjatë auditimeve të bëra nga auditit i brendshëm janë gjetur një numër i madh subjektësh privatë dhe familjarë që furnizohen me ujë pa patur kontratë me U.K.T. sh.a.

vazhdimisht

29. U.K.T. sh.a të marrë masa për të përcaktuar zonat e nxehta ku janë përqëndruar ndërhyrjet në rrjet (lidhjet e paligjshme) duke bërë ndërprerjet e tyre për të ulur humbjet në rrjet.

vazhdimisht

30. Të merren masa për rritjen e transparencës ndaj klientëve që kanë ankesa për mbifaturime, verifikim të matësit të ujit, duke i zgjidhur problemet e çdo abonentit në vend pa e detyruar qytetarin që të bëjë ankesë në drejtorinë e U.K.T.sh.a.

vazhdimisht

31. Në treguesit e performancës të U.K.T.sh.a, për çdo sektor, Degë, Departament dhe Njësitë 1,2,3,4 duhet të përfshihen edhe ankesat e qytetarëve, nëpërmjet caktimit të kufirit minimal të lejuar për numrin e ankesave të qytetarëve në muaj, për:

- Respektimin e orareve të furnizimit me ujë për çdo zonë të qytetit Tiranës, të caktuar nga U.K.T. sh.a dhe të publikuar në faqen e internetit të shoqërisë.

- Për ndërprerjet e përkohshme të pa njoftuar nëpërmjet medias qytetarët,

Për mbifaturimet, për faturimet afrofe, për mosvendosje të matësve të ujit, për faturim të subjekteve private si familjarë, për furnizim me ujë pa lidhur kontratë me ujësjellësin, për lidhje të paligjshme, për shpërdorim të ujit pijshëm etj, tejkalimi i të cilave vlerësohet si mosrealizim treguesish.

menjëherë

32. Titullari Autoritetit Kontraktor në caktimin e anëtarëve të KVO nuk duhet të caktojë punonjës që kanë hartuar e miratuar projektet, që kanë marrë pjesë në llogaritjen e vlerës limit të kontratës për objektin që prokurohet, pasi përbën konflikt interesi me detyrën

Vazhdimisht

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik me vlerë 1,341,600 lekë duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, vlerë e përfituar padrejtësisht nga shoqëria [REDAKTUAR] Sh.p.k, si pasojë e likuidimit punimeve të cilat kanë rezultuar të pakryera.
2. Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik me vlerë 699,198 lekë duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, vlerë e përfituar padrejtësisht nga shoqëria [REDAKTUAR] Sh.p.k, si pasojë e likuidimit punimeve të cilat kanë rezultuar të pakryera.
3. Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik me vlerë 1,268,400 lekë duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, vlerë e përfituar padrejtësisht nga shoqëria [REDAKTUAR] Sh.p.k, si pasojë e likuidimit punimeve të cilat kanë rezultuar të pakryera.
4. Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik me vlerë 1,421,822 lekë duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, vlerë e përfituar padrejtësisht nga shoqëria [REDAKTUAR] Sh.p.k, si pasojë e likuidimit punimeve të cilat kanë rezultuar të pakryera.
5. Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik me vlerë 332,520 lekë duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, vlerë e përfituar padrejtësisht nga shoqëria [REDAKTUAR] Sh.p.k, si pasojë e likuidimit punimeve të cilat kanë rezultuar të pakryera.

C. MASA ADMINISTRATIVE

1. Për shkeljet e konstatuara në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje tuba dhe rakorderi për nevojat e shoqërisë” për vitin 2010 , mbështetur në nenin 72, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik” i ndryshuar Kreu X “**SANKSIONET ADMINISTRATIVE DHE MASAT DISIPLINORE**” të kërkohet pranë APP-së marrja e masës administrative për anëtarët e KVO-së si më poshtë:

Gjobë në shumën 100 000 lekë, për

1. [REDAKTUAR] kryetare e KVO
2. [REDAKTUAR] anëtarë i KVO
3. [REDAKTUAR] anëtarë i KVO

Për arsye se:

Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje tuba dhe rakorderi për nevojat e shoqërisë ”, me Urdhër Prokurimi nr.8827,datë 14.10.2010, kufi monetar në vlerën 209.550.270 lekë,pa tvsh, procedurë tender i hapur:

Ka kualifikuar dhe shpallur fitues operatorin ekonomik Dule shpk me vlerë oferte 167.560.084 lekë pa tvsh në kundërshtim me pikën 3 të nenit 53 të ligjit nr.9643, datë si dhe pikës 4 germa c,

të kreut V të VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i cili nuk ka paraqitur kontrata të ngjashme, ndërkohë që ka skualifikuar - Bashkimin e operatorëve Amu sh.p.k & Kronsos Konstruksion me vlerë oferte 152.673.137 dhe operatorin ekonomik “Jordil” sh.p.k me vlerë oferte 155.179.401 lekë të cilët janë skualifikuar padrejtësisht.

2. Për shkeljet e konstatuara në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje tuba dhe rakorderi për nevojat e shoqërisë” për vitin 2010, mbështetur në nenin 72, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik” i ndryshuar Kreu X “**SANKSIONET ADMINISTRATIVE DHE MASAT DISIPLINORE**” të kërkohet pranë APP-së marrja e masës administrative për anëtarët e Njësisë Prokurimit dhe Komisionit të llogaritjes së vlerës limit të kontratës të kërkohet dhënia e masave disiplinore:

“Vërejtje”

1. [REDAKTUAR] juriste
2. [REDAKTUAR] anëtare
3. [REDAKTUAR] anëtare

Për arsye se:

Në tenderin e mësipërm në dokumentet e tenderit pikën III “Kapaciteti Teknik” të Kriteve të Veçanta për Kualifikim, ka përcaktuar se: Operatori ekonomik duhet të paraqesë kontrata të së njëjtës natyrë me objektin e prokurimit realizuar në tre vitet e fundit, shoqëruar këto me vërtetimin përkatës në vlerën 40% të fondit limit.

Vendosja e kriteve jo të plota në përputhje me DST bie në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, Kreu III pika 3 germa b ku thuhet se: Dëshmitë për furnizimin e mallrave duhet të jepen përmes vërtetimeve të marrësit të mallit ose/dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Për të njëjtin qëllim autoriteti kontraktor duhet të pranojë dhe dëshmi të tjera, siç mund të jenë raportet financiare të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse, nga të cilat dalin qartë të dhënat për vlerat e furnizimeve, të kryera nga operatori ekonomik. Vendosja e kriteve jo të plota në përputhje me DST ka sjell konfuzion në vlerësimet e bëra nga KVO duke skualifikuar operatorë ekonomik.


Për anëtarët e llogaritjes së vlerës së kontratës:

1. [REDAKTUAR]
2. [REDAKTUAR]
3. [REDAKTUAR]

Për llogaritjen e vlerës limit të kontratës jo në përputhje me kërkesat e pikës 2, germa c të kreut II Rregullat e Përgjithshme të Prokurimit VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

3. SHA “Ujësjetës Kanalizime” Tiranë, mbështetur në nenet 7, 9 dhe 15, të ligjit Nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, në Nenin 5, Pika b, të Ligjit Nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektoratin e ndërtimit”, t’i kërkojë “**Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik**” të **Bashkisë Tiranë**, ndëshkimin për kundërvajtje administrative dhe dënimin me gjobë në masën **50 000** lekë, për shoqëritë dhe mbikëqyrësit e punimeve si më poshtë:

- 1.
- 2.
- 3.
- 4.
- 5.



Për mos kontrollin periodik në fazat më kryesore të ndërtimit, për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit, gjatë zbatimit të kontratave të punimeve civile.

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në rregulloren e brendshme të shoqërisë dhe bazuar në kontratën kolektive , i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm që të fillojë procedura për dhënien e masave disiplinore për Drejtuesit e Departamenteve të Shitjes, Ekonomike, Shërbimeve të Përgjithshme, Njësive 1, 2, 3, 4 për performancë të ulët në realizimin e objektivave të programuara për vitin 2011 sipas shkallës hierarkie të drejtimit nga niveli ulët deri ai më i lartë bazuar në gjetjet e trajtuara në raportin e auditimit si dhe ato të auditimit të brendshëm.

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Rustem Tare, Artan Topjana, Nefail Xhepehxiu, më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Athanas Karaja, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktike nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT